



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.35/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Violeta Rugova Husaj kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën [REDACTED] të parashtruar ndaj KQZ-së, për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ANKESA ZL.Anr 35/2025 e datës 11.09.2025, e parashtruar nga [REDACTED] për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 11.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL.Anr.35/2025 nga [REDACTED], me vendbanim Suharekë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak se më është mohuar padrejtësisht pa asnjë arsyetim të ligjshëm e drejta për të ushtruar të drejtën time kushtetuese për të votuar me postë nga diaspora.

Parashtruesi i ankesës thekson se ka aplikuar për votim me postë nga diaspora brenda afatit përpara datës 29 gusht 2025., dhe aplikimi im është miratuar nga KQZ dhe, si dëshmi më është dërguar dëftesa e aprovimit, të cilën isha i obliguar ta bashkëngjis me materialin e votimit.

Në listën e publikuar nga KQZ me datë 28 gusht 2025 figuron emri im si aplikues i sukseshëm për votim me postë. Mirëpo, në listën përfundimtare, emri im është hequr pa paralajmërim dhe pa njoftim zyrtar.

Ky veprim i KQZ-së, përveç që është arbitrar, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtës sime për të votuar.

Bazimi juridik: Neni 10, paragrafi 4 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme garanton të drejtën e shtetasve të Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit për të ushtruar të drejtën e votes

përmes postës, nëse aplikimi është bërë në përputhje me procedurat. Neni 10, paragrafi 5 obligon KQZ-në që pas miratimit të aplikimit të sigurojë trajtim të barabartë dhe të garantuar të së drejtës për aplikuesin. Neni 10, paragrafi 6 ndalon çdo mohim të së drejtës së votës pa vendim të arsyetuar ligjërisht dhe pa njoftim të palës. Neni 6, paragrafi 3 i Rregullores së PZAP-it nr. 01/2025 përcakton se çdo veprim ose vendim që kufizon apo ndikon në ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje në zgjedhje duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i komunikohet subjektit të prekur.

Dokumentet e paraqitura si prova: dëftesa e aprovimit dhe një kopje e letërnjoftimit.

Në përgjigje në kërkesë KQZ ka theksuar se shtetasi [REDAKTUAR] (më tej parashtruesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike.

Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDAKTUAR] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2,7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar, [REDAKTUAR] gjatë aplikimit ka dhënë numër të telefonit jo funksionale. Te njëjtin numër e kanë kontaktuar tri here në ditë të ndryshme dhe i njëjti numër nuk ka ekzistuar. Gjithashtu email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nën paragrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil.

Email adresa e përdorur [REDAKTUAR] nuk është adresë personale. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës të parashtruar nga ankuesi, vëren se të njëjtat janë të pa bazuara. Paneli, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *“4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përfshijtur dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1... ”.*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se, parashtuesi i ankesës është verifikuar nga KQZ dhe nga verifikimi i këtyre dëshmive është konstatuar se parashtuesi i ankesës me rastin e aplikimit për regjistrim votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, nuk ka dhënë numër të telefonit funksionalë dhe Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, dhe si e tillë është në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil.

Nga KQZ është verifikuar se numri i telefonit nuk është funksional dhe Email adresa [redacted] shifet qartazi se nuk përputhet me të dhënat e votuesit.

Bazuar në të lartcekurat, PZAP konstaton se në këtë çështje, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, andaj pretendimet e ankuesit nuk janë të bazuara.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtuesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresës personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil, kriter ky i përcaktuar shprehimisht në nenin 3 paragrafi 5 pika 5.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 3 paragrafi 5 pika 5.1 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr. 35/2025 më datën 12.09.2025

Kryesuese e Panelit,
Violeta Rugova Husaj



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.